



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 5 maj 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Trupit Gjykses I

---

### Gjykatësve të Trupit Gjykses I:

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula (gjykatës rezervë)

### Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

### Mbrojtësit të Salih Mustafës:

Julius von Bone

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(b) dhe 40(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja e Caktimit të Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi formon Trupin Gjykues I pas njoftimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se dosja e plotë e kësaj çështjeje gjyqësore do të jetë gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues më 7 maj 2021 (“Njoftimi”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër z. Salih Mustafa, një version i redaktuar i së cilës u bë publik më 2 tetor 2020.<sup>2</sup>
2. Më 24 shtator 2020, z. Salih Mustafa u arrestua në Kosovë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë të Holandës.<sup>3</sup>
3. Më 5 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake protokolloi njoftimin sipas rregullës 98(3) të Rregullores se dosja e plotë e kësaj çështjeje gjyqësore do të jetë gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues më 7 maj 2021.<sup>4</sup>

## II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kritereve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores së Caktimit të Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe

---

<sup>1</sup> F00112, Njoftim sipas Rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 5 maj 2021.

<sup>2</sup> Shih F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës, 5 tetor 2020 (origjinali protokolluar më 12 qershor 2020); F00011/RED/A01, Version i Redaktuar Publik i “Aktakuzës”, i datës 19 qershor 2020, 2 tetor 2020.

<sup>3</sup> Shih F00013, Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4), 24 shtator 2020; F00014, Njoftim për Pranim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 24 shtator 2020.

<sup>4</sup> Shih Njoftimi.

disponueshmërinë në këtë moment,

**ME KËTË VENDIM, KRYETARJA ÇAKTON:**

**Gjykatësin Roland Dekers**

**Gjykatësen Mapi Feld-Folia**

**Gjykatësin Zhilber Biti**

**Gjykatësin Vladimir Mikula (gjykatës rezervë)**

në këtë çështje gjyqësore si Trupi Gjykses I, me t'u bërë kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**

**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E mërkurë, 5 maj 2021

Hagë,

Holandë